

UDHËZUES I THIRRJES PËR PROJEKT PROPOZIME



**UDHËZUES I THIRRJES
PËR PROJEKT PROPOZIME**

NOMAD TECH

Tabela e Përmbajtjes

1.	Hyrje	3
2.	Çfarë është “NOMAD TECH”?.....	4
3.	Kush mund të aplikojë?	5
3.1	Kriteret e Pranueshmërisë	6
3.2	Kriteret e Përfshirimit (Mos pranueshmërisë)	7
3.3	Numri i Aplikimeve	8
4.	Mbështetja Financiare dhe Përdorimi i Fondeve	8
4.1	Shuma e Grantit	8
4.2	Bashkëfinancimi (Cost-sharing)	9
4.3	Kostot dhe Aktivitetet e Pranueshme	9
4.4	Aktivitetet e Papranueshme	10
4.5	Kostot e Papranueshme	11
4.6	Dokumentet që duhet të dorëzohen	12
4.7	Kohëzgjatja dhe disbursimi i grantit.....	15
5.	Procesi i aplikimit dhe vlerësimit	15
5.1	Procesi i aplikimit.....	15
5.2	Procesi i Vlerësimit	16
6.	Kontraktimi.....	18
6.1	Afatet.....	19
7.	Ankimimet.....	19
8.	Sesionet Informuese	20

1. Hyrje

Ky është një udhëzues për individët dhe ekspertët që aplikojnë në Thirrjen e Hapur për përgatitjen e dokumentacionit të granteve në kuadër të programit “NOMAD TECH – Fuqizimi i Gjeneratës së Ardhshme të Novatorëve”.

Ky dokument shpjegon qartë se kush mund të aplikojë për këtë angazhim profesional, cilat janë përgjegjësitë dhe rezultatet e pritshme, dokumentacioni që kërkohet të dorëzohet, kriteret e përzgjedhjes dhe mënyra e vlerësimit të aplikimeve. Gjithashtu, përfshin udhëzime praktike mbi procesin e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të dokumentacionit.

Të gjitha informacionet dhe dokumentet e nevojshme në lidhje me këtë Thirrje të Hapur do të jenë të disponueshme në faqen zyrtare të Programit ose përmes kanaleve zyrtare të komunikimit të Programit “NOMAD TECH”.

Ju lutemi vini re se aplikimi duhet të dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike, brenda afatit të përcaktuar. Rekomandohet që gjatë përgatitjes së aplikimit të konsultoni me kujdes këtë dokument udhëzues për të siguruar përputhshmëri të plotë me kërkesat dhe formatin e kërkuar.

Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet këtij Udhëzuesi dhe informacioneve të publikuara on-line, do të ketë përparësi informacioni i publikuar në njoftimin zyrtar të Thirrjes së Hapur.

2. Çfarë është “NOMAD TECH”?

“NOMAD TECH – Fuqizimi i Gjeneratës së Ardhshme të Novatorëve” është një Program për mbështetjen e Start-up-eve dhe të rinjve novatorë në Shqipëri, pjesë e një nisme më të gjerë për zhvillimin e ekosistemit të teknologjisë së lartë dhe ekonomisë dixhitale në vend.

Qëllimi i Programit NOMAD TECH është të nxisë fuqizimin ekonomik të të rinjve shqiptarë përmes zhvillimit të aftësive digjitale dhe sipërmarrëse, mbështetjes së ideve novatore dhe krijimit të një ekosistemi të qëndrueshëm për inovacion dhe zhvillim teknologjik. Përmes një skeme të strukturuar të nën-grantimit, trajnim profesional dhe mentorim nga ekspertë të industrisë, Programi synon të përshpejtojë rritjen e Start-up-eve me potencial në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.

NOMAD TECH u ofron përfituesve mbështetje për të kapërcyer pengesat fillestare që shpesh kufizojnë zhvillimin e ideve të reja, duke krijuar një mjedis ku inovacioni mund të lulëzojë dhe të zbatohet në mënyrë praktike. Supozimi është se, pa ndërhyrjen e Programit, shumë prej këtyre nismave do të mbeteshin në fazë idesh ose nuk do të arrinin potencialin e tyre të plotë.

Programi zbatohet nga Organizata LIBURNETIK, me mbështetjen e Philip Morris International, dhe ka një kohëzgjatje totale prej 24 muajsh. Gjatë kësaj periudhe, ai synon të përfshijë dhe mbështesë një numër të konsiderueshëm profesionistësh të rinj, start-up-e premtuese dhe aktorë të tjerë të ekosistemit të inovacionit, duke krijuar lidhje të reja me investitorë dhe partnerë strategjikë në nivel ndërkombëtar.

Për qëllimet e këtij programi, si Start-up konsiderohen:

Persona fizikë ose juridikë të regjistruar në Shqipëri që operojnë në sektorët e teknologjisë së lartë dhe ekonomisë digjitale, me një ide, produkt apo shërbim novator dhe potencial për rritje të shpejtë dhe zgjerim.

Novacioni vlerësohet në raport me kontekstin lokal shqiptar: a ofron një zgjidhje të re ose të përmirësuar për një problem ekzistues? A sjell përfitime të matshme për komunitetin apo tregun vendas?

3. Kush mund të aplikojë?

Thirrja në kuadër të Programit “NOMAD TECH – Fuqizimi i Gjeneratës së Ardhshme të Novatorëve” është e hapur për Start-up-e shqiptare, të krijuara rreth një koncepti novativ biznesi, të cilat janë tashmë të regjistruara ose që planifikojnë të regjistrohen dhe të operojnë në Shqipëri.

Fondi i nën-grantimit të Programit mbështet tri nënkategori të Start-up-eve:

Fasha 1: Faza e Idesë dhe Validimit

Një themelues ose ekip që ndodhet në hapat e parë të zhvillimit të një ideje inovative biznesi (ende e paregjistruar në QKB).

Fasha 2: Faza e Rritjes

Një entitet biznesi aktiv i regjistruar në QKB prej të paktën 12 muajsh deri në datën e publikimit të kësaj Thirrjeje për Projekt-propozime, 22.04.2025.

Fasha 3: Faza e zhvillimit

Një entitet biznesi aktiv i regjistruar në QKB nga 2-8 vite deri në datën e publikimit të kësaj Thirrjeje për Projekt-propozime, 22.04.2025.

Një start-up në çdo sektor është i pranueshëm për aplikim. Nuk ka kufizime sektoriale, përveç atyre të përmendura në vetë deklaratimet, pjesë e pandashme e paketës së aplikimit.

Megjithatë, prioritet do t’u jepet sektorëve me rëndësi për ekonominë aktuale shqiptare, ose sektorëve ku Shqipëria ka përparësi krahasuese në kontekstin rajonal, të BE-së apo global, të tillë si:

- IT dhe Zgjidhje Digjitale
- Shërbime biznesi
- Turizëm
- Bujqësi e Qëndrueshme, përpunim ushqimor, pylltari dhe peshkim
- Tranzicioni i gjelbër dhe digjital
- Ekonomia qarkulluese
- Përpunimi i drurit
- Industria e veshjeve dhe tekstilit
- Industria e këpucëve dhe përpunimit të lëkurës
- Energjia e rinovueshme
- Menaxhimi i mbetjeve dhe aktivitetet e rehabilitimit
- Riciklimi dhe ripërdorimi kreativ

NOMAD TECH promovon barazinë gjinore dhe grupet vulnerabël, përfshirë:

- rritjen e përfshirjes së grave dhe grupet vulnerabël në punësim,
- mbështetjen për gratë sipërmarrëse dhe grupet vulnerabël
- përfshirjen gjinore në ekipe.

Start-up-et të drejtuara nga gra, si dhe ato që operojnë në fusha me pjesëmarrje të lartë të grave, grupet vulnerabël, inkurajohen posaçërisht të aplikojnë.

Projektet duhet të marrin parasysh aspektet mjedisore dhe klimatike. Ide biznesi, produkte dhe procese inovative që janë të përqendruara në teknologji miqësore me mjedisin, kursim energjie dhe përdorimin e burimeve alternative të energjisë, do të kenë përparësi. Start-up-et që ofrojnë zgjidhje të tilla inkurajohen fort të aplikojnë.

Gjithashtu, Start-up-et me përmbajtje të theksuar teknologjike dhe potencial për rritje ndërkombëtare janë shumë të inkurajuara të aplikojnë.

3.1 Kriteret e Pranueshmërisë

Për të qenë të pranueshëm për një grant në kuadër të Programit NOMAD TECH, aplikuesit duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

1. Të jenë persona juridikë (entitete biznesi – MSME), të regjistruar dhe që operojnë në Shqipëri (*aplikuesit për Fashat 2 & 3*);
2. Të sigurojnë regjistrimin e start-upit si një entitet biznesi – MSME dhe funksionimin e tij në Shqipëri (*aplikuesit për Fashën 1*);
3. Aplikuesit nga diaspora shqiptare dhe joshqiptarë janë të pranueshëm, për sa kohë që aktiviteti i biznesit do të zhvillohet në Shqipëri;
4. Të mos kenë qenë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit për më shumë se 8 vjet, nga data e publikimit të kësaj Thirrjeje për Projekt-propozime;
5. Statusi i funksionimit të biznesit të jetë AKTIV në momentin e aplikimit. (*për Fashat 2 & 3*);
6. Të sigurojnë bashkëfinancimin e kërkuar sipas përqindjes së përcaktuar në Udhëzuesin e Aplikimit (seksioni përkatës mbi financimin);
7. Të mos kenë detyrime tatimore të papaguara ndaj autoriteteve shtetërore dhe vendore (*aplikuesit për Fashat 2 & 3*);
8. Të mos jenë subjekt i ndjekjes penale nga organet ligj zbatuese;
9. Të mos kenë procese penale aktive në gjykatë;

10. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale;
11. Të jenë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve të përshkruara në aplikim, nuk lejohet aplikimi në emër të palëve të treta.
12. Të kenë Pasqyrat financiare të vitit të fundit (Viti 2024 – Për Fashën 1 atëherë kur është e mundur dhe për Fashën 2).
13. Të kenë Pasqyrat financiare të 2 viteve të fundit (Vitet 2023 dhe 2024 – vetëm për Fashën 3).

3.2 Kriteret e Përrjashtimit (Mos pranueshmërisë)

Aplikuesit do të përjashtohen automatikisht nga procesi i vlerësimit dhe nuk do të konsiderohen për përfitim nga fondi i Programit **“NOMAD TECH”**, nëse:

1. Nuk plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në seksionin 3.1 të këtij Udhëzuesi;
2. Kanë dorëzuar një aplikim jo të plotë ose me dokumentacion të paplotë, ose kanë plotësuar të dhëna të pasakta apo të rreme në formularin e aplikimit;
3. **Nuk paraqesin dokumentet zyrtare që provojnë mungesën e proceseve penale aktive**, ndjekjeve penale apo dënimeve të formës së prerë për vepra penale (si: dëshmi penaliteti, vërtetim nga Gjykata dhe nga Prokuroria);
4. Janë aktualisht nën ndjekje penale, kanë procese gjyqësore në zhvillim, ose janë dënuar për vepra penale me vendim të formës së prerë të Gjykatës;
5. **Kanë detyrime tatimore të papaguara** ndaj autoriteteve shtetërore dhe vendore (e aplikueshme për Fashën 1 kur është e mundur dhe për Fashat 2 dhe 3);
6. Kanë më shumë se 8 vjet të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit nga data e publikimit të kësaj Thirrjeje për Propozime;
7. **Kanë status “jo aktiv” ose të pezulluar në QKB** në momentin e aplikimit ose të kenë ndryshuar në status “aktiv” pas datës së publikimit të thirrjes (Fashat 2 dhe 3);
8. Nuk sigurojnë përqindjen përkatëse të bashkëfinancimit, sipas kërkesave të përcaktuara për secilën Fashë;
9. Janë palë të treta që aplikojnë në emër të dikujt tjetër, dhe jo subjektet që do të zbatojnë vetë projektin;
10. **Nuk nënshkruajnë vetë deklarin për shmangien e konfliktit të interesit**, ose rezultojnë në situatë konflikti interesi me donatorin ose organizatën zbatuese;
11. **Nuk respektojnë kufizimet teknike të dorëzimit të dokumenteve**, si madhësia e skedarëve, formati i gabuar, etj.

3.3 Numri i Aplikimeve

Çdo aplikues ka të drejtë **të dorëzojë vetëm një (1) aplikim** në kuadër të Thirrjes së parë për aplikime të Programit “NOMAD TECH”.

Nuk lejohet:

- Dorëzimi i më shumë se një aplikimi nga i njëjti aplikues, qoftë në të njëjtën Fashë apo në Fasha të ndryshme (pra, një aplikuesi, në total mund të aplikojë vetëm me një projekt-propozim).
- Dorëzimi i të njëjtit aplikim me emra apo e-maile të ndryshme për të shmangur kufizimin për një aplikim të vetëm.

Nëse konstatohet që një aplikues ka paraqitur më shumë se një aplikim, të gjitha aplikimet e tij do të skualifikohen automatikisht nga procesi i vlerësimit, pavarësisht përmbajtjes apo cilësisë së tyre.

Prandaj, rekomandohet që aplikuesit të vlerësojnë me kujdes Fashën për të cilin janë më të përshtatshëm dhe të përgatisin një aplikim të vetëm, të plotë dhe të saktë.

4. Mbështetja Financiare dhe Përdorimi i Fondeve

4.1 Shuma e Grantit

Në kuadër të kësaj Thirrjeje për Aplikime, mbështetja financiare ofrohet përmes tre nënkategorive të Start-Up-eve, të strukturuar sipas fazës së zhvillimit dhe statusit ligjor të tyre:

Fasha	Fasha e Start-up-it	Statusi Ligjor	Shuma maksimale e grantit
Fasha 1	Ide & Validim	Start-up i paregjistruar (do të regjistrohet pas përzgjedhjes)	deri në 2,000,000 lekë
Fasha 2	Faza e Rritjes	I regjistruar brenda 12 muajve të fundit	deri në 5,000,000 lekë
Fasha 3	Faza e Zhvillimit	I regjistruar prej 2 deri në 8 vjet	deri në 10,000,000 lekë

Granti **nuk duhet të tejkalojë përqindjet maksimale të mbështetjes në raport me buxhetin total të projektit:**

- **Fasha 1:** maksimumi **95%** e buxhetit total
- **Fasha 2:** maksimumi **90%** e buxhetit total
- **Fasha 3:** maksimumi **80%** e buxhetit total

4.2 Bashkëfinancimi (Cost-sharing)

Një element i rëndësishëm i Programit **NOMAD TECH** është bashkëfinancimi i detyrueshëm nga ana e aplikantit. Granti jepet mbi bazën e ndarjes së kostove, ku aplikanti kontribuon me një përqindje të përcaktuar të buxhetit total.

Përqindja që duhet të bashkë financohet nga aplikuesi:

Fasha	Minimumi i bashkëfinancimit nga aplikanti
Fasha 1	5% e buxhetit total
Fasha 2	10% e buxhetit total
Fasha 3	20% e buxhetit total

Forma e bashkëfinancimit:

- **Në të holla (cash)** – pagat pranohen **vetëm si kontribut në cash**.
- **Në natyrë (in-kind)** – për shembull, pajisje apo aktive fikse, për sa kohë që: Pajisjet apo aktivet justifikohen me dokumentacion përkatës.

4.3 Kostot dhe Aktivitetet e Pranueshme

Grantet e Programit **NOMAD TECH** synojnë të mbështesin zbatimin e ideve të qëndrueshme të biznesit dhe rritjen e start-upeve inovative. Fondet e përfituara mund të përdoren për një gamë të gjerë aktiviteteve, për sa kohë që ato janë të arsyeshme dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektivat e projektit të propozuar.

Aktivitetet dhe kostot e pranueshme përfshijnë:

- **Kosto për burime njerëzore** (deri në 30% të buxhetit total): paga bruto, përfshirë kontributet ligjore;
- **Shpenzime administrative:** qira për zyra, shërbime teknike dhe mirëmbajtje (deri në 10% të buxhetit total);
- **Kosto të zbatimit:** blerje pajisjesh dhe mjeteve, komunikim, lëndë të para për prodhim, promovim dhe marketing;
- **Zhvillim teknologjik dhe testim produkti/prototipi;**
- **Trajnim dhe mentorim të stafit;**
- **Ekspertizë e jashtme,** përfshirë konsulencën në dizajn produkti, zhvillim biznesi, rregullore ligjore etj.

Të gjitha kostot duhet të jenë të justifikuara dhe të lidhura me aktivitetet e planifikuara në Planin e Aktiviteteve dhe të përputhen me linjat buxhetore të formularit të buxhetit.

Punimet infrastrukturore nuk mund të financohen.

4.4 Aktivitetet e Papranueshme

Për të siguruar përdorimin e drejtë, efektiv dhe të qëllimshëm të fondeve publike të Programit **“NOMAD TECH”**, disa aktivitete dhe kosto konsiderohen **të papranueshme** për financim nga granti. Këto përjashtime janë të detyrueshme dhe vlejné për të gjithë aplikuesit, pavarësisht Fashës.

Nuk do të mbështeten financiarisht aktivitetet që përfshijnë:

- **Shpenzime për qëllime personale** apo që nuk lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e projektit të biznesit;
- **Shpenzime për aktivitete jashtë territorit të Shqipërisë**, përveç rasteve kur justifikohen drejtpërdrejt me nevojat e projektit dhe miratohen paraprakisht nga donatori;
- **Shpenzime për aktivitete me karakter politik, fetar apo ideologjik;**
- **Pagesa të borxheve ekzistuese, interesa huash ose gjoba dhe penalitete;**
- **Investime në asete të paluajtshme**, si blerje tokash, ndërtesash ose pasuri të tjera të ngjashme;
- **Kosto jo reale apo të pajustificuara** që nuk janë në përputhje me tregun apo me objektivat e projektit;
- **Shpenzime për aktivitete që përfitojnë persona apo entitete që nuk janë të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatimin e projektit;**
- **Pagesa për personel që nuk është i deklaruar dhe i përfshirë në mënyrë transparente në propozim;**
- **Blerje të pajisjeve që do të transferohen apo dhurohen brenda 2 viteve pas përfundimit të projektit**, pa pëlqimin me shkrim të organizatës zbatuese;
- **Produkte të falsifikuara, shkelje të pronësisë intelektuale ose aktivitete në kundërshtim me ligjin shqiptar;**
- **Aktivitete që janë tashmë të financuara nga një burim tjetër**, pa deklaram të saktë dhe të plotë për mbivendosjen e fondeve (double funding).

Të gjitha shpenzimet dhe aktivitetet e propozuara duhet të jenë në përputhje me Planin e Aktiviteve, Formularin e Buxhetit dhe objektivat e aplikimit.

4.5 Kostot e Papranueshme

Në kuadër të kësaj Thirrjeje për Aplikime, **disa kategori kostosh konsiderohen të papranueshme për financim nga granti i Programit “NOMAD TECH”.**

Këto kosto nuk duhet të përfshihen në propozimin financiar dhe, nëse identifikohen gjatë procesit të vlerësimit apo zbatimit, nuk do të mbulohen nga fondi i grantit.

Kostot më poshtë nuk janë të pranueshme për financim:

- **Borxhet dhe interesat për shërbimin e borxhit;**
- **Rezervat për humbje apo detyrime të mundshme të ardhshme;**
- **Kosto të deklaruar dhe të financuara nga një projekt tjetër ose program tjetër (double funding);**
- **Blerja e tokës ose ndërtesave;**
- **Blerja e automjeteve dhe telefonave celularë,** përveç rasteve kur justifikohen si absolutisht të domosdoshëm për realizimin e projektit;
- **Humbje nga kursi i këmbimit valutor;**
- **Kosto për garanci bankare apo çdo garanci tjetër financiare;**
- **Gjobat, penalitetet financiare dhe shpenzimet për mosmarrëveshje ligjore;**
- **Kosto të leasing-ut,** përfshirë pajisje apo automjete të marra me qira financiare, përveç rasteve kur justifikohen si absolutisht të domosdoshëm për realizimin e projektit;
- **Kredidhënie për palë të treta,** ose aktivitete që financojnë entitete të tjera jo të përfshira në projekt;
- **Taksa e regjistrimit të biznesit,** apo çdo shpenzim i lidhur me formalizimin e subjektit pas përzgjedhjes;
- **Produkte apo shërbime të ndaluara sipas praktikave të BE-së,** përfshirë sektorët e mëposhtëm:
 - Prodhimi apo tregtimi i **alkoolit, duhanit, produkteve të lojërave të fatit;**
 - Aktivitetet e lidhura me **industrinë ushtarake** apo të mbrojtjes.
- **Shpenzime personale** apo të luksit që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektivat e projektit;

- **Rimëkëmbje e kostove të bëra përpara datës së kontratës së grantit;**
- **Pagesa për staf të padeklaruar, jo të përfshirë në propozimin e aplikimit;**
- **Aktivitete që janë tashmë të mbuluara nga financime të tjera, pa transparencë të plotë;**
- **Blerje të pajisjeve që nuk janë të përfshira në mënyrë të qartë në formularin e buxhetit ose që nuk justifikohen me argument të fortë;**
- **Shpenzime për aktivitete jashtë territorit të Shqipërisë, përveç rasteve të miratuara me shkrim nga organizata zbatuese;**
- **Transferimi i pajisjeve të financuara të palë të treta brenda 2 viteve nga përfundimi i projektit, pa leje të posaçme.**

Për prokurimin e pajisjeve, ju lutemi specifikoni çdo produkt që planifikoni të blini gjatë zbatimit të idesë së biznesit. Nevoja për këtë lloj kostoje duhet të shpjegohet në detaje në propozim dhe pajisja nuk mund të jetë subjekt i transferimit të pronësisë për të paktën dy vjet pas përfundimit të kontratës së grantit. Një kosto nuk mund të përfshihet në më shumë se një Kategori apo nën kategori buxheti ose në më shumë se një linjë buxhetore brenda të njëjtit aktivitet

Çdo shpenzim i papranueshëm i paraqitur në buxhet ose i realizuar gjatë projektit mund të rezultojë në reduktim të shumës së grantit ose në kërkesë për rimbursim nga përfituesi.

4.6 Dokumentet që duhet të dorëzohen

Përveç **formularit të aplikimit (1)** që duhet të plotësohet on-line në platformën zyrtare të aplikimit, aplikuesit duhet të ngarkojnë dhe dorëzojnë edhe dokumentacionin shtesë si më poshtë, sipas fashës përkatëse:

Fasha 1 – Faza e Idesë dhe Validimit

1. Formulari i buxhetit i Plotësuar – format Excel
2. Kanavaca e Modelit të Biznesit (KMB) – në format PDF
3. Plani i Aktiviteteve – në format PDF
4. Karta e Identitetit e Themeluesit të Start-up-it – I skanuar në format PDF
5. CV e Themeluesit të Start-up-it – në format PDF
6. CV të anëtarëve të ekipit – në format PDF

7. Dëshmi Penaliteti e themeluesit të start-up-it, e lëshuar brenda tre muajve nga data e aplikimit (burimi: <https://e-Albania.al/>) - e skanuar në format PDF
8. Dokument i lëshuar nga Gjykata që vërteton se themeluesi i start-up-it nuk ka asnjë çështje penale në proces, i lëshuar brenda tre muajve nga data e aplikimit - i skanuar në format PDF.
9. Dokument i lëshuar nga Prokuroria që vërteton se themeluesi i start-up-it nuk është nën hetim nga prokuroria, i lëshuar brenda tre muajve nga data e aplikimit - i skanuar në format PDF.
10. Për aplikuesit jo-shqiptarë: Leja e qëndrimit e themeluesit të start-up-it – e skanuar në format PDF.
11. Vetë deklarami për shmangien e konfliktit të interesit.
12. Deklarata e Pranimit të Kushteve të thirrjes.
13. Pasqyra financiare e vitit të fundit (2024) kur është e mundur.

Fasha 2 - Faza e Rritjes

1. Formulari i buxhetit i Plotësuar – format excel
2. Kanavaca e Modelit të Biznesit (KMB) – *në format PDF*
3. Plani i Aktiviteteve – *në format PDF*
4. Karta e Identitetit e Themeluesit të Start-up-it – *I skanuar në format PDF*
5. CV e stafit kryesor dhe CV e administratorit të start-up-it të bashkuara në një dokument – *në format PDF*
6. Akti i regjistrimit (NUIS) i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), nga data e hapjes së kësaj thirrjeje për propozime (burimi: <https://e-Albania.al/>) - *i skanuar në format PDF*
7. Ekstrakt historik i nxjerrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) ose Gjykatës së Rrethit Tiranë, nga data e hapjes së kësaj thirrjeje për propozime (burimi: <https://e-Albania.al/>) - *i skanuar në format PDF*
8. Vërtetim për pagim detyrimesh tatimore (Pa borxh), lëshuar nga data e hapjes së kësaj thirrjeje për propozime (burimi: <https://e-Albania.al/>) - *në format PDF*
9. Dëshmi Penaliteti e themeluesit të start-up-it, e lëshuar brenda tre muajve nga data e aplikimit (burimi: <https://e-Albania.al/>) - *e skanuar në format PDF*

10. Dokument i lëshuar nga Gjykata që vërteton se themeluesi i start-up-it nuk ka asnjë çështje penale në proces, i lëshuar brenda tre muajve nga data e aplikimit - *i skanuar në format PDF*.
11. Dokument i lëshuar nga Prokuroria që vërteton se themeluesi i start-up-it nuk është nën hetim nga prokuroria, i lëshuar brenda tre muajve nga data e aplikimit - *i skanuar në format PDF*.
12. Për aplikuesit jo-shqiptarë: Leja e qëndrimit e themeluesit të start-up-it – *e skanuar në format PDF*.
13. Vetë deklarami për shmangien e konfliktit të interesit.
14. Deklarata e Pranimit të Kushteve të thirrjes.
15. Pasqyra financiare e vitit të fundit (2024).

Fasha 3 – Faza e Zhvillimit

1. Formulari i buxhetit i Plotësuar – format excel
2. Kanavaca e Modelit të Biznesit (KMB) – *në format PDF*
3. Plani i Aktiviteteve – *në format PDF*
4. Karta e Identitetit e Themeluesit të Start-up-it – *i skanuar në format PDF*
5. CV e stafit kryesor dhe CV e administratorit të start-up-it të bashkuara në një dokument – *në format PDF*
6. Akti i regjistrimit (NUIS) i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), nga data e hapjes së kësaj thirrjeje për propozime (burimi: <https://e-Albania.al/>) - *i skanuar në format PDF*
7. Ekstrakt historik i nxjerrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) ose Gjykatës së Rrethit Tiranë, nga data e hapjes së kësaj thirrjeje për propozime (burimi: <https://e-Albania.al/>) - *i skanuar në format PDF*
8. Vërtetim për pagim detyrimesh tatimore (Pa borxh), lëshuar nga data e hapjes së kësaj thirrjeje për propozime (burimi: <https://e-Albania.al/>) - *në format PDF*
9. Dëshmi Penaliteti e themeluesit të start-up-it, e lëshuar brenda tre muajve nga data e aplikimit (burimi: <https://e-Albania.al/>) - *e skanuar në format PDF*
10. Dokument i lëshuar nga Gjykata që vërteton se themeluesi i start-up-it nuk ka asnjë çështje penale në proces, i lëshuar brenda tre muajve nga data e aplikimit - *i skanuar në format PDF*.

11. Dokument i lëshuar nga Prokuroria që vërteton se themeluesi i start-up-it nuk është nën hetim nga prokuroria, i lëshuar brenda tre muajve nga data e aplikimit - *i skanuar në format PDF.*
12. Për aplikuesit jo-shqiptarë: Leja e qëndrimit e themeluesit të start-up-it – *e skanuar në format PDF.*
13. Vetë deklarami për shmangien e konfliktit të interesit
14. Deklarata e Pranimit të Kushteve të thirrjes
15. Pasqyrat financiare të 2 viteve të fundit (2023, 2024)

Ju lutemi sigurohuni që file juaj të jetë i optimizuar siç duhet, me madhësinë maksimale prej 5 MB për çdo file PDF të ngarkuar.

4.7 Kohëzgjatja dhe disbursimi i grantit

Kohëzgjatja e zbatimit të projektit është nga 4 deri në 10 muaj kalendarik, në përputhje me planin e aktiviteteve të dorëzuar nga aplikanti dhe të miratuar në kontratë. Granti duhet të shfrytëzohet brenda kësaj periudhe.

Disbursimi i grantit (ndarja dhe lëshimi i fondeve) do të vlerësohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave specifike dhe nevojave të secilës start-up. Si rrjedhojë, fondet mund të disbursohen në dy ose më shumë transhe.

Transhi përfundimtar, që përfaqëson 10% të kostove totale të pranueshme, do të lëshohet pas përfundimit të projektit në formë rimbursimi dhe pas miratimit të raportit përfundimtar narrativ dhe financiar nga autoriteti kontraktues, të shoqëruara me dokumentacionin justifikues.

5. Proces i aplikimit dhe vlerësimit

5.1 Proces i aplikimit

Aplikimet duhet të dorëzohen VETËM on-line në platformën e NOMAD TECH. Aplikimet që dorëzohen me mjete të tjera (me postë, e-mail, dorazi, etj.) do të refuzohen.

Hapat bazë të procesit të aplikimit janë si më poshtë:

1. Një Thirrje për Propozime, që përfshin edhe afatin për dorëzim të aplikimeve, shpallet në platformën e aplikimeve, në faqen e internetit të NOMAD TECH: apliko.nomadtech.al

2. Pas zgjedhjes së fashës përkatëse, aplikuesi duhet të plotësojë formularin on-line të aplikimit, i cili përbëhet nga seksionet:

- a. Informacione mbi start-upin
- b. Propozimi i biznesit
- c. Ngarkimi i dokumenteve përkatëse, sipas përshkrimit në seksionin 4.6 të këtij dokumenti

Çdo pyetje në lidhje me procesin e aplikimit duhet të dërgohet me shkrim, përmes e-mailit, jo më vonë se 15 ditë para mbylljes së procesit të aplikimit.

Autoriteti kontraktues nuk është i detyruar të japë sqarime për pyetje të dërguara pas këtij afati.

Pyetjet duhet të dërgohen në adresën: apliko@nomadtech.al duke përmendur referencën e Thirrjes për Propozime.

Përgjigjet për pyetjet e bëra do të publikohen në faqen e internetit të NOMAD TECH, në seksionin: “FAQ – Thirrja për Propozime”, jo më vonë se 11 ditë para afatit të mbylljes së procesit të aplikimit.

5.2 Procesi i Vlerësimit

Procesi i vlerësimit do të jetë **i hapur, transparent dhe konkurrues**. Të gjitha aplikimet që dorëzohen në përputhje me rregullat dhe afatet do të **kalojnë përmes një procesi formal të vlerësimit**.

Procesi i vlerësimit përbëhet nga këto faza kryesore:

1. Verifikimi administrativ dhe i pranueshmërisë

- Kontrollohet që të gjitha dokumentet e kërkuara janë dorëzuar.
- Kontrollohet përmbushja e **kritereve të pranueshmërisë dhe përjashtimit**.

Vetëm aplikimet që kalojnë këtë fazë do të kalojnë në **vlerësimin teknik dhe financiar**.

2. Vlerësimi teknik dhe financiar

Kategoria	Kriteri Specifik	Pikët Maksimale
1. Rëndësia e Idesë	Adreson një nevojë reale në treg / komunitet	10
	Niveli i novacionit të idesë	10
2. Qartësia e Planit të Biznesit	Objektivat janë të qarta, realiste dhe të matshme	5
	Përshkrimi i qartë i produkteve/shërbimeve	5
	Analiza e tregut dhe konkurrentëve	5
	Strategjia e marketingut dhe shitjeve	5
3. Zbatueshmëria	Aftësia për të zbatuar projektin në kohë dhe me burimet e propozuara	10
	Përvoja e ekipit ose themeluesve	10
4. Ndikimi i Pritshëm	Potenciali për rritje dhe shkallëzim	5
	Kontributi në zhvillimin ekonomik, punësim ose përfshirje sociale	5
5. Aspektet Financiare	Buxheti i arsyetuar dhe i qartë	10
	Qëndrueshmëria financiare pas përfundimit të grantit	5
6. Përputhshmëria me Prioritetet	Përputhshmëria me prioritetet tematike të thirrjes (p.sh. digjitalizim, gjelbërim)	5
7. Novacioni Social / Gjinia	Përfshirja e grupeve të pa favorizuara ose qasje gjinore / sociale	5

TOTALI I PIKËVE: 100

3. Procesi i prezantimit (vetëm për ata që do të kontaktohen)

Pas vlerësimit administrativ, përmbajtësor dhe financiar do të kontaktohen aplikuesit më të mirë të cilët do të bëjnë një prezantim para një jurie të përshtatshme në lidhje me projekt-propozimet.

4. Publikimi i listës përfundimtare të përfituesve

Pas vlerësimit, do të hartohet një **listë përfundimtare e aplikuesve fitues**, e cila do të publikohet në faqen zyrtare të NOMAD-TECH.

6. Kontraktimi

Pas shpalljes së listës përfundimtare të përfituesve, aplikuesit fitues do të kontaktohen nga autoriteti kontraktues, Organizata **LIBURNETIK**, për të nisur procesin e lidhjes së kontratës së grantit.

Procesi i kontraktimit përfshin:

- përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për nënshkrimin e kontratës së grantit;
- negocimin e mundshëm dhe finalizimin e kushteve të disbursimit dhe të raportimit;
- përditësimin dhe/ose saktësimin e disa të dhënave në aplikim, nëse është e nevojshme.

Kontrata do të përshkruajë në mënyrë të detajuar:

- të drejtat dhe detyrimet e përfituesit dhe të organizatës zbatuese;
- strukturën e disbursimit të grantit;
- afatet dhe format e raportimit teknik dhe financiar;
- mekanizmat e monitorimit dhe kontrollit;
- kushtet për ndërprerje apo rikuperim të grantit, në rast të shkeljes së kushteve kontraktuale.

Përfituesi është i detyruar të nënshkruajë kontratën dhe të zbatojë aktivitetet e miratuara në përputhje me planin e veprimit dhe dokumentacionin e dorëzuar gjatë aplikimit.

Nëse përfituesi nuk përmbush detyrimet për nënshkrimin e kontratës brenda afatit të përcaktuar ose nuk i përgjigjet komunikimeve zyrtare, e drejta për financim mund të revokohet dhe granti mund t'i kalohet aplikuesit të radhës në listën e përzgjedhjes.

6.1 Afatet

Tabela më poshtë përshkruan afatet orientuese për çdo fazë të Thirrjes për Aplikime në kuadër të Programit **“Nomad Tech – Fuqizimi i Gjeneratës së Ardhshme të Novatorëve”**. Organizata zbatuese mund të ndryshojë këto afate nëse e konsideron të nevojshme dhe çdo ndryshim do të publikohet zyrtarisht në faqen e Programit nomadtech.al

Aktiviteti	Afati orientues
Publikimi i Thirrjes për Aplikime për Projekt-propozime	22 Prill 2025
Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve	31 Maj 2025, ora 23:59
Periudha e vlerësimit	Qershor 2025
Njoftimi i përfituesve dhe nisja e procesit të kontraktimit	Qershor – Korrik 2025

Shënim: Afatet janë orientuese dhe mund të ndryshojnë. Çdo përditësim do të publikohet në faqet zyrtare të komunikimit të Programit “Nomad Tech”.

7. Ankimimet

Aplikuesit që nuk janë përzgjedhur si përfitues të grantit kanë të drejtë të paraqesin një ankesë të argumentuar me shkrim në rast se:

- konsiderojnë se procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar në përputhje me udhëzimet e kësaj Thirrjeje për Aplikime;
- dyshojnë për mospërputhje administrative, parregullsi ose mosrespektim të procedurave të publikuara.

Ankesat duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në adresën info@nomadtech.al brenda **10 ditëve kalendarike** nga data e njoftimit të rezultateve.

Autoriteti kontraktues do të shqyrtojë çdo ankesë dhe do të japë përgjigje brenda **10 ditëve kalendarike** nga data e marrjes së saj.

Vendimi mbi ankesat është përfundimtar dhe nuk mund të apelohe.

8. Sesionet Informuese

Në kuadër të Thirrjes për Aplikime, organizata LIBURNETIK do të organizojë sesione informuese për të ndihmuar aplikuesit potencialë që të kuptojnë më mirë:

- objektivat e Programit “Nomad Tech”;
- kriteret e pranueshmërisë dhe vlerësimit;
- procesin e aplikimit on-line dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar.

Datat, oraret dhe vendndodhjet e sesioneve informuese do të publikohen në faqet zyrtare të komunikimit të Programit.